



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 3368 prot.

Tiranë, më 28.06.2019

VENDIM

Nr. 3368, datë 28.06.2019

PËR

CAKTIMIN E SHITESAVE MAKROPRUDENCIALE TË KAPITALIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 2, shkronja ‘b’; nenit 11, pikat 1 dhe 7; nenit 12, pika 3; nenit 14, pikat 5, 6, 7, 8 dhe 9; dhe nenit 16, pika 1, shkronja ‘a’, ‘ç’ dhe ‘d’, të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (më poshtë, ‘rregullorja 41/2019’), bazuar në propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar,

VENDOSA:

1. Norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë është 0 për qind.
2. Bankat me rëndësi sistemike (BARS) dhe shtesat përkatëse e kapitalit (SIST), përcaktohen si me poshtë:

BARS	SIST	SIST për periudhën 29 mars – 31 dhjetor 2020
Banka Kombëtare Tregtare sh.a.	1.5 për qind	0.5 për qind
Banka Raiffeisen sh.a.	1.0 për qind	0.5 për qind
Banka Credins sh.a.	0.5 për qind	0.5 për qind
Banka Intesa Sanpolo Albania sh.a.	0.5 për qind	0.5 për qind

3. Shtesat makroprudenciale të kapitalit sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, zbatohen së bashku me shtesën konservuese të kapitalit (KONS) sipas tabelës 2, të nenit 10, pika 1, të rregullores 41/2019.
4. Shtesat makroprudenciale të kapitalit, sipas pikës 3 të këtij vendimi, zbatohen dhe mbahen në nivel institucioni të veçantë (*solo basis*).
5. Bankat duhet të raportojnë shkallën e përmbushjes së shtesave makroprudenciale të kapitalit sipas paragrafit 3 të këtij vendimi, në datën 29 mars 2020.
6. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në faqen e internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
7. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR

Gent Sejko